



KPMG Albania Shpk Dega në Kosovë
Rruga "Sulejman Vokshi"
Nr.14
Prishtinë ,Kosovë

Telefon +381 (38)246771
Faks +381 (38)246772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

RAPORT AUDITIMI

MBI PASQYRAT FINANCIARE
TË KOMUNËS MAMUSHË
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtine, Korrik 2013

TABELA E PËRMBAJTJES

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
QELLIMI DHE METODOLOGJIA E AUDITIMIT.....	4
I. OPINIONI I AUDITIMIT.....	5
II. PASQYRAT FINANCIARE – PAJTUESHMËRI ME KORNIZËN RAPORTUESE	8
II.1 PAJTUESHMËRI ME KORNIZËN RAPORTUESE	8
II.2 CILËSIA DHE SAKTËSIA E INFORMACIONEVE NË PASQYRAT VJETORE FINANCIARE.....	8
III. GJENDJA E REKOMANDIMEVE TË VITEVE TË KALUARA	9
IV. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI.....	10
IV.1 HYRJE	10
IV.2 PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI BUXHETOR	10
IV.3 RAPORTIMI AKTUAL DHE AFATET KOHORE NË PROÇESIN E PËRGJITHSHËM BUXHETOR	11
IV.4 TË HYRAT (DUKE PËRFSHIRË ATO VETJAKE).....	11
IV.5 SHPENZIMET	12
IV.6 PASURITË	13
IV.7 TRAJTIMI I BORXHEVE.....	14
V. SISTEMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM	15
V.1 SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM	15
V.2 KOMITETI I AUDITIT	15
VI. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM MBI MENAXHIMIN E KOMUNËS MAMUSHE	16
SHTOJCA 1. LLOJET E NDRYSHME TË OPINIONEVE TË AUDITIMIT TE APLIKUARA NGA KPMG NË AUDITIMIN VJETOR 2012	17
SHTOJCA 2: REKOMANDIMET E VITIT TE MEPARSHEM	18
SHTOJCA 3. KOMENTET E MENAXHMENTIT TE KOMUNËS SË MAMUSHËS DHE PËRGJIGJET E KPMG-SË	22

Permbledhje ekzekutive

Hyrja

KPMG ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare ('PVF') të Komunës së Mamushes ("Komuna"), në emër të Zyrës së Auditorit Përgjithshëm në Kosovë, për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012.

Ky raport përmbledh çështjet kryesore të identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne duam të falenderojmë Kryetarin e Komunes dhe stafin e tij për bashkëpunimin e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të nxjerra nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne gjykojmë se ishin të nevojshme për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare.

Fokusi ynë është përqendruar mbi mjaftueshmërinë e shumave dhe shpalosjeve në PVF për të dhënë një siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi. Procedurat tona përfshijnë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve e procedurave të kontabilitetit deri në masën që gjykohet e nevojshme për përgatitjen efektive të auditimit. Gjetjet tona nuk duhet të konsiderohen si nje përmbledhje gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që ekzistojnë, ose e të gjitha përmirësimeve të cilat mund t'iu bëhen sistemeve dhe procedurave ekzistuese.

Konkluzioni ynë përmbledhës për Manaxhmentin e Komunës paraqitet në pikën VI të këtij raporti.

Kontrolli i Brendshëm

Gjatë auditimit ne kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto mangësi janë përshkruar më hollësisht brenda këtij raporti.

Konkluzioni ynë është që sistemi i kontrolleve të brendshme të Komunës nuk është përcaktuar dhe nuk është zbatuar siç duhet për të eliminuar dobësitë e dukshme.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe i kontrolleve të brendshme, ne i rekomandojmë Komunës që të sigurojë:

- Një listë e plotë e pronave, ndërtesave dhe pajisjeve të Komunës;
- Vendosja e një sistemi automatik të faturimit për të gjitha llojet e taksave;
- Marrjen e masave për të rritur mbledhjen e të hyrave nga taksat e ndryshme; dhe
- Pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-042 'Ligji për Prokurorimin Publik në Kosovë' (i ndryshuar).

Menaxhmentit të Komunës i është ofruar mundësia të japin komentet për gjetjet tona të prezantuara në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar të gjitha rekomandimet tona.

Referojuni Shtojcës 3 për komentet e menaxhmentit për rekomandimet tona dhe përgjigjen tonë ndaj tyre.

Qëllimi dhe metodologjia e auditimit

Ky auditim ka të bëjë me pasqyrat vjetore financiare të Komunës Mamushe, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012.

Është përgjegjësia e Komunës të përgatisë pasqyrat vjetore financiare sipas kërkesave të Rregullit Financiar 07/2011 dhe në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

KPMG, në emër të Zyres së Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor për pasqyrat financiare të Komunes për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2012.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare si dhe jep siguri në:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Çështje të tjera me rëndësi të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisve tona për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi krahasuar pasqyrat vjetore financiare në raport me buxhetin e miratuar për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat vjetore financiare të Komunës janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe Rregullit Financiar nr. 07/2011;
- Kemi përcaktuar nivel të materialitetit, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2012.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës, ONISA standartet ndërkombëtare të auditimit, përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

Këto janë të përcaktuara më gjerësisht në Shtojcën 1, që përfshin një ekstrakt nga ISSAI 400.

I. Opinioni i Auditimit

Për Komunën Mamushë,

Prishtinë, 2 Korrik 2013

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Komunës Mamushë ("Komuna"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012, një krahasim të buxhetit me shumat aktuale, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe të shënimeve të tjera sqaruese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik ("SNKSP") *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Rregullën Financiare Nr. 07/2011 *Pasqyrat Vjetore të Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezantimin e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion bazuar në auditimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me Parimet dhe Direktivat Thelbësore të Auditimit të Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të arritur një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerësojmë këto rreziqe, kontrolli i brendshëm i entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare merret në konsideratë në mënyrë që të planifikojmë procedura auditimi të përshtatshme në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo për qëllimin që të shprehim një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së pasqyrave financiare.

Ne besojmë së evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të kualifikuar.

Bazat për Opinionin e Kualifikuar

- 1 Pagesat e pranura nga palët e treta paraqitur në Nenin 12 të "Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme" në 2012 përfaqëson shumat që nuk kanë dokumentacion mbështetës, ndërkohë që nuk ka pasur asnjë shumë të tillë në informacionin krahasues për 2011 dhe 2010. Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për Pagesa të pranura nga palët e treta.
- 2 Informacioni krahasues për vitet 2011 dhe 2010 nuk është i plotë dhe i saktë. Në veçanti, nenet në vijim mungojnë ose nuk janë paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare:
 - Neni 12 "Pasqyra e pranimeve dhe pagesave" nuk pajtohet me Nenin 13 "Raportin e ekzekutimit të buxhetit", dhe me shënimet 8, 15, dhe 16 për vitin 2011 dhe shënimet 7 dhe 15 për vitin 2010.
 - Informacioni krahasues për vitet 2011 dhe 2010 nuk pajtohet me pasqyrat financiare të audituara për vitin 2011. Informacioni jo konsistent është paraqitur në Nenin 12, Nenin 13, Shënimin 4, Shënimin 9 dhe Shënimin 15.
 - Shënim 35 "Bilanci i të hyrave vetanake të papërdorura" nuk pajtohet me Shënimin 15 "Të hyrat vetanake" për vitin 2010.

Opiniononi i kualifikuar

Sipas opinionit, përveç mungesës së informacionit të përshkruar në Nenin mbi bazat e kualifikimit të opinionit, pasqyrat financiare prezantojnë drejt në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2012 në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik në baza të parasë së gatshme ('IPSAS') për *Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit në Baza Të Parasë së gatshme* dhe me Rregullin Financiar Nr. 07/2011 *Mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore*.

Theksim i çështjes

Pa kualifikuar më tej opinionin tonë, ne tërheqim vëmendjen si në vijim:

- Komuna nuk ka regjistruar shumat e plota në Nenin 16 'Shpalosja e pasurive' si dhe nuk ka mbajtur një regjister gjithëpërshires të pasurive. Për disa prona, mund të ketë paqartësi në lidhje me të drejtat e pronësisë midis Komunës dhe Agjencive të tjera të ndryshme të Qeverisë së Kosovës, dhe mungesë të dokumentacionit mbështetës të pronësisë. Për më tepër, si pasojë e mungesës së dokumentacionit përkatës për matjen e një pjese të konsiderueshme të këtyre aseteve, Komuna ka kërkuar të masë këto objekte me vlerën e drejtë në bazë të një vlerësimi të kryer nga një komitet i brendshëm.
- Shumat e paraqitura në Shënimin 34 "Të arkëtueshmet" paraqesin një vlerësim të përgjithshëm të kryer nga komuna për mbledhjet e ardhshme nga taksat dhe tatimet e tjera, sesa informacion të detajuar bazuar në taksat e arkëtueshme nga tatim paguesve.

Çështje të tjera

Pasqyrat Financiare të Organizatës për mbylljen e vitit 31 Dhjetor 2011 janë audituar nga një auditues tjetër, raportim më 29 Qershor 2012 I cili ka shprehur një opinion të kualifikuar mbi pasqyrat financiare. Kualifikimet të cilat lidhen me paraqitjen e informacioneve aktuale dhe krahasuese të pasakta dhe jo të plota, duke përfshirë mungesën e informacionit mbi pagesat nga palët e treta, regjistrimin dhe vlerësimin e pronës, ndërtesave dhe pajisjeve, dhe paraqitja e llogarive të arkëtueshme.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe shtirja e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me ato të hartuara për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë rishikimin me qëllim që të marrim një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare janë në të gjithë aspektet materiale në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- 1 Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Megjithatë, meqenese Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta dhe faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm që të prodhojë pasqyra të plota financiare.
- 2 Megjithëse Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka dorëzuar një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri më 31 janar 2013.
- 3 Meqenëse Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, ekziston një pasiguri lidhur me plotësinë e të arkëtueshmeve dhe të hyrave që Komuna mund të fitojë, aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
- 4 Ne kemi identifikuar një numër të prokurimeve që janë paraqitur si shpenzime kapitale, sesa si shpenzimet për mallra dhe shërbime, sipas natyrën përkatëse. Sikur këto shpenzime të ishin klasifikuar në kategorinë e duhur, buxheti për mallra dhe shërbime do të kishte qenë tejkaluar nga 11 mijë euro.
- 5 Edhe pse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe flukset dalëse monetare të ardhshme mund të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente.

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch

Sulejman Vokshi, No. 14

Prishtinë

Kosovë

II. Pasqyrat Financiare – Pajtueshmëri me kornizën raportuese

Rishikimi ynë i pasqyrave vjetore financiare ("PVF") merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft Pasqyrat Vjetore Financiare të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e pasqyrave vjetore financiare përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikëve në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

II.1 Pajtueshmëri me kornizën raportuese

Kërkesat nga LMFPP Nr. 03/L-048 dhe Rregulli Financiar nr. 07/2011.

- Komuna ka përgatitur pasqyrat financiare sipas Rregullit Financiar 07/2011.
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar i njësisë së audituar;
- Pasqyrat Financiare nuk janë nënshkruar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financës ("MF") brenda kornizës së kërkuar kohore më 31 janar 2013;
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar në Ministrinë e Financës vetëm në gjuhën Shqipe; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek MF gjatë vitit 2012.

Rekomandimi 1

Komuna duhet të përgatisë Pasqyrat Financiare në gjuhën Serbe në mënyre periodike.

II.2 Cilësia dhe saktësia e informacioneve në pasqyrat vjetore financiare

Të Gjeturat

Burimi kryesor e i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Meqenese Free Balance nuk përdoret për të regjistruar pagesat nga palët e treta, ose faturat e papaguara, nuk mund të përdoret vetëm që të prodhojë pasqyra të plota financiare per vitin e perfunduar më 31 dhjetor 2012.

- 1 Komuna nuk ka paraqitur shumat e plota në Nenin 16 "Shpalosja e pasurive".
- 2 Pagesat e marra nga palët e treta nuk janë paraqitur në Shënimin 12 të "Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave" për 2011 dhe 2010.
- 3 Shënimi 21, mbi ndryshimet midis shpenzimeve të buxhetuara dhe aktuale, nuk shpjegon arsyen për ndryshimet në kategorinë e kostove të personelit.
- 4 Informacioni krahasues për vitet 2011 dhe 2010 nuk është i plotë dhe i saktë. Në veçanti, informacioni në vijim mungon ose nuk është paraqitur siç duhet në pasqyrat financiare.
 - Neni 12 "Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave" nuk është në pajtueshmëri me Nenin 13 "Raporti i ekzekutimit të buxhetit", dhe me Shënimet 8, 15, dhe 16 për 2011 dhe Shënimet 7 dhe 15 për 2010.
 - Informacioni krahasues për vitet 2011 dhe 2010 nuk pajtohet me pasqyrat financiare të audituara për vitin 2011. Informacioni jo konsistent është paraqitur në Nenin 12, Nenin 13, Shënimin 4, Shënimin 9 dhe Shënimin 15.
 - Shënim 35 "Bilanci i të hyrave vetanake të papërdorura" nuk pajtohet me Shënimin 15 "Të hyrat vetanake" për vitin 2010.

Rekomandimi 2

Ne i rekomandojmë që Kryetari i Komunës të sigurohet së përgatitja e pasqyrave financiare të përfshijë procedura dhe mjete të dizajnuara për sigurimin që informatat e kërkuara të jenë të regjistruara, të procesuara, të përmbledhura dhe të raportuara në mënyrë të përshtatshme në pasqyra financiare.

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë mbi PVF për vitin 2011, ka të përfshirë 11 rekomandime kryesore, nga të cilat vetëm një është zgjidhur dhe tre janë zgjidhur pjesërisht gjatë vitit 2012 (shih më poshtë), të tjerat mbeten për t'u adresuar, duke përfshirë:

- 1 Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në përputhje instruksionet aktuale administrative dhe SNKSP; Kontrolle të përmirësuara mbi përdorimin e buxheteve dhe investimeve kapitale;
- 2 Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës, që do të përfshijë procedura dhe mjete, të cilat janë hartuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare.
- 3 Përmirësimi në cilësinë e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare;
- 4 Duhet të adoptohet një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave dhe duhet të ndërmerren masa që të rriten mbledhjet e taksave e ndryshme;
- 5 Përmirësimet duhet të implementohen për shpenzimet dhe prokurorimet (*pjesërisht të adresuara gjatë 2012*);
- 6 Procedura të përshtatshme të kontrollit për një monitorim efektiv mbi përpuethshmërisë mbi ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me subvencionet dhe transferimet;
- 7 Burime shtesë (të vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar) duhet të përfshihen në rregjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës, si dhe veprimet që duhet të ndërmerren në rregjistrimin e pasurive në regjistrin përkatës dhe kryerjen e numërimeve të rregullta fizike (*pjesërisht të adresuara gjatë 2012*);
- 8 Hartimit të procedurave adekuate të kontrollit të brendshëm për të përmbushur kërkesat për raportim financiar të jashtëm (*pjesërisht të adresuara gjatë 2012*);
- 9 Përmirësime në kontrollet administrative financiare dhe menaxheriale; dhe
- 10 Përmirësime në kontrollet e brendshme dhe themelimi i një Komiteti Auditimi dhe të një funksioni Auditit të Brendshëm për të rishikuar statusin aktual dhe për të propozuar veprime për përmirësim në fusha të rëndësishme. Komiteti i Auditit duhet të themeloje politika dhe procedura për të siguruar standarte të larta të qeverisjes.

IV. Menaxhimi financiar dhe kontrolli

IV.1 Hyrje

Ne kemi kuptuar dhe kemi kryer një vlerësim të veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhimin efektiv financiar si dhe kontrollin. Për sistemet financiare individuale ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin kontrollet aktuale veprojnë. Ky mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë ose kontrolli operative në nivele të ulëta. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe veprojnë në mënyrë efektive.

IV.2 Planifikimi dhe realizimi buxhetor

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimin e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të ardhurave të grumbulluara. Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve aktuale në '000 EUR:

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Granti Qeveritar	970	-	1,009	1,003	981	753
Të barturat nga viti paraprak	-	-	77	47	-	-
Të hyrat vetanake	58	-	58	6	6	17
Donacionet e vendit	-	-	1	1	-	-
Donacionet e jashtme	-	-	-	-	-	-
I. Gjithsejt pranimet dhe donacionet e transferuara	1,028	-	1,145	1,057	987	770
Pagat dhe mëditjet	700	-	700	694	636	507
Mallra dhe shërbime	79	-	161	160	86	112
Shpenzimet komunale	22	-	23	23	21	21
Subvencionet dhe transferet	3	-	3	3	1	1
Investimet kapitale	224	-	258	177	236	129
Rezervat	-	-	-	-	-	-
II. Gjithsej pagesa	1,028	-	1,145	1,057	980	770
Ndryshimi I-II	-	-	-	-	7	-

Shumat e buxhetuara janë nxjerrë nga pjesët në vijim të Pasqyrave Financiare në dhe gjatë vitit të mbyllur 31 dhjetor 2012: Neni 13 *Raporti i ekzekutimit të buxhetit*, Neni 12: *Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave*, dhe Neni 18: *Harmonizimi i ndarjeve origjinale dhe finale të buxhetit*.

Konkluzion

Totali i të ardhurave aktuale dhe transferimet e donacioneve ishin më të ulëta se buxheti final prej 88 mijë Eur për shkak të realizimit më të ulët të të ardhurave vetanake prej 82 mijë Eur dhe Granteve të Qeverisë më të ulëta të marra prej 6 mijë Eur.

Totali i daljeve të parasë ishte më i ulët se buxheti final prej 88 mijë Eur për shkak të rrogave dhe pagave më të ulëta prej 6 mijë Eur, mallra dhe shërbime më të ulëta prej 1 mijë Eur, dhe shpenzimet kapitale më të ulëta prej 81 mijë Eur.

Buxheti fillestar ishte më i ulët prej 117 mijë Eur nga buxheti përfundimtar për shkak të: alokimit shtesë nga granti qeveritar prej 39 mijë, të hyra vetanake dhe të hyra vetanake të bartura prej 77 mijë Eur dhe grante dhe donacione prej 1 mijë Eur. Të gjitha ndryshimet në buxhetin fillestar janë miratuar siç duhet miratuar me rishikimin e buxhetit, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës apo miratuar nga Kryetari i Kuvendi Komunal. Këto ndryshime janë mbështetur edhe nga vendimi i kuvendit dhe jane të lejuara nga korniza ligjore ligji 03/L-048.

Buxheti i pa-shpenzuar i Komunës gjatë 2012 është 7.7%.

Neni 13 *Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit* nuk pajtohet me Nenin 12: *Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave* për 2011 dhe 2010. Një diferencë prej 7 mijë Eur rezulton në 2011, ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve.

IV.3 Raportimi aktual dhe afatet kohore në procesin e përgjithshëm buxhetor

Përmbushja e detyrimeve aktuale të raportimit të jashtëm, si dhe procesi i tij buxhetor:

- Kërkesat buxhetore u realizuan në kohën e duhur;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare për nëntë mujorin janë dorëzuar në kohën e duhur në MF;
- Draft plani i prokurimit është dorëzuar në kohë në MF;
- Plani i Veprimit për rekomandimet zbatuese është përfshirë në pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Të Gjeturat

Nuk ka gjetje të tjera për raportim në këtë fushë.

IV.4 Të hyrat (duke përfshirë ato vetjake)

Të Gjeturat

Gjatë testimeve tona kemi vëne re:

- *Sistemi i faturimit.* Një sistem automatik i faturimit ekziston vetëm për të hyrat nga tatimi në prone. Komuna nuk mban regjistra të faturimit për llojet e tjera të të ardhurave. Në vend të kësaj vetëm arkëtimet me para të gatshme nga të hyrat e tilla janë regjistruar.
- *Mbledhja e të hyrave:* Përveç tatimit mbi pronën, Menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra të vecantë ose ndonjë listë të të gjithë debitorëve sipas llojeve të ndryshme të taksave. Pa të dhëna të detajuara, të sakta dhe të mjaftueshme të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë normën e saktë të mbledhjes ose të ndjekë mbledhjen e të hyrave vetanake.
- *Dobësitë e sistemit të automatizuar të faturimit.* Sistemi i faturimit të tatimit në pronë është i centralizuar dhe Komuna ka qasje të kufizuar në sistemin. Kufizime të tilla kufizojnë aftësinë e Komunës për të gjeneruar raporte të rregullta dhe gjithëpërfshirëse për mbledhjen e të ardhurave dhe arkëtimet e lidhura, dhe si rezultat dëmtojnë aftësinë për të monitoruar siç duhet dhe për të shqyrtuar mbledhjet e tilla. Edhe pse raportet e tilla gjenerohen automatikisht nga sistemi me bazë të centralizuar, Komuna nuk i përdor ato rregullisht. Për më tepër, lista e mbledhjeve për vitin e gjeneruar nga sistemin për tatimin mbi pronë nuk është pajtuar dhe nuk pajtohet me mbledhjet e regjistruara në Free Balance.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe të faturimit në mënyrë që të sigurojë kontrolle të sigurta, efeciente dhe efektive në faturim dhe të hyra. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do të mundësonte menaxhmentit të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe të sigurohet që vendimet në lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë Komunës të konsiderojë të:

- Implementojë një sistem faturimi që të përfshijë detaje të përditësuara për pagesit, adresën e tyre të tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes së të hyrave nga këta pages. Qasje në informacione të tilla duhet të jetë e limituar për vetëm një numër të personave dhe duhet të jenë të autorizuar nga menaxhmenti.
- Vendosë dhe të kontrollojë tarifat dhe normat e taksave në sistem në mënyrë qendrore, që të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet të autorizohet dhe të rishikohet.
- Ekzistojë lidhje në mënyrë automatike midis sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyre që të procesohen të dhënat në librin kryesor në mënyre automatike.
- Mundësojë lidhjen automatike të zyrës së faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta ndërmjet tyre, për rastet kur faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operationale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh transaksionesh.

IV.5 Shpenzimet

5.1 Prokurorimet

Të gjeturat

Shpenzimet për prokurorimet nr. 626 12 017 236, 626 12 018 236 dhe 626 12 003 236, janë paraqitur si shpenzime kapitale, në vend të paraqitjes si shpenzime për mallra dhe shërbime, respektivisht sipas natyrës. Nëse këto shpenzime do të kategorizoheshin në kategorinë e saktë, buxheti për mallrat dhe shpenzimet do të ishte tejkualuar prej 11 mijë Eur.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshëm për përmirësimin e kontrolleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plotë me ligjet dhe kerkesat e rregulloreve lokale.

5.2 Shpenzime të tjera

Të gjetura

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

5.3 Kompensime (rrogat dhe pagat)

Të gjetura

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

5.4 Subvencionet dhe transferimet

Të Gjetura

Komuna nuk ka politika të shkruara mbi subvencionet, që do të përmbanin kritere dhe procedurat për lejimin e subvencionit, pra subvencionet janë të lejuara vetëm bazuar në vendimin e Kryetarit të Komunës.

Rekomandimi 5

Komuna duhet të ndërtojë procedura kontrolli të përshtatshme të mjaftueshme, për monitorimin efektiv mbi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi, në lidhje me subvencionet dhe transferimet.

IV.6 Pasuritë

6.1 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalenteve të saj

Të Gjeturat

Mbledhjet e parasë nuk janë depozituar në llogari bankë në baza ditore ashtu siç kërkohet nga Rregullorja 04/2007 e Ministrisë së Shëndetësisë.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë se Komuna do të marrë hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontrolleve dhe të jetë në përputhje me kërkesat ligjit dhe rregulloret lokale në lidhje me arkëtimet.

6.2 Trajtimi i të arkëtueshmëve

Të Gjeturat

Komuna nuk ka një proces të dizajnuar mirë për identifikimin, evidentimin dhe përcjelljen deri në faturat e lëshuara për taksat e saj. Komuna ka paraqitur një shume të vlerësuar të të arkëtueshmeve në pasqyrat e saj financiare. Nuk u dhanë dokumenta mbështetëse për të dhënat në pasqyrat financiare dhe nuk janë gjetur lista të detajuara në Komunë.

Rekomandimi 7

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurojë që do të dizajnohet dhe do të ndërtohet një proces i cili do të bëjë të mundur që të arkëtueshmet do të regjistrohen gjatë lëshimit të cdo fature dhe që shumat e mbetura do të ndiqen rregullisht. Lista të detajuara duhet të mbahen për cdo të dhënë të pasqyrave financiare.

6.3 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Të Gjeturat

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës për pronat, ndërtesat dhe pajisjet e saj, përfshirë këtu datën e blerjes/shitjes të aktivitetit gjithashtu edhe zhvlerësimin për vitin. Për më tepër, Komuna nuk mban një regjistër të ndarë për aktivitetet dhe nuk ka regjistruar njëjtë me Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar në Kosovë dhe nuk mban regjistër të ndarë për aktivitetet nën 1,000 Eur. Gjithashtu, Komuna ka kryer numërimin vjetor dhe verifikimin e ekzistencës fizike të aktiveve më 31 dhjetor 2012, por nuk ka rakorduar librat e saj me numërimin fizik, gjë e cila nuk është në përputhshmëri me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 21/2009 mbi Menaxhimin e Pronës Shtetërore. Bilanci i ndërtesave jo rezidente ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012 dhe neve nuk na është dhënë një shpjegim në lidhje me këto ndryshime.

Pagesat e marra nga palët e trata të shfaqura në Nenin 12 për "Pasqyrat e pranimeve dhe pagesave" në 2012 përfaqësojnë shuma të cilat nuk janë të mbështetura nga dokumentacioni, kurse shuma të tilla nuk ishin të përfshira në informacionin krahasues për 2011 dhe 2010. Komuna nuk ka ndonjë procedurë formale që do të siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për pagesat e marra nga palët e trata.

Për disa aktive të caktuara, ka pasiguri nëse të drejtat e pronësisë i takojnë Komunës apo një sere Agjencish të tjera të Qeverisë së Kosovës dhe ka mungesë në dokumentacionin mbështetës të pronësisë.

Për shkak të mungesës së dokumentacionit mbështetës për matjen e një pjese të konsiderueshme të pronave, objekteve dhe pajisjeve, të shpalosura në Shënimin 30, Komuna ka kërkuar për të matur artikuj të tillë në vlerën e drejtë bazuar në vlerësimin e bërë nga një komisioni i formuar i brendshëm.

Diferenca në mes të bilanceve të paraqitura në Shënimin 30 dhe Shënimin 31, për vitet 2011 dhe 2012, nuk pajtohet me shtesat totale për vitin 2012 të paraqitura në Shënimin 11. Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar të lëvizjeve në vitin 2012, për të mundësuar rakordimin e informacioneve të prezantuara në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 8

Ne rekomandojmë që Kryetari të përfshijë burime shtesë në regjistrimin, kontrollimin dhe vlerësimin e aseteve të Komunës.

IV.7 Trajtimi i borxheve

Të Gjeturat

Nuk ka përjashtime të mëdha të identifikuara.

V. Sistemi i Auditimit të Brendshëm

V.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

V.2 Komiteti i Auditit

Të Gjetura

Komuna nuk ka një Departament Auditit të Brendshëm apo një Komitet Auditit.

Rekomandimi 9

Ne rekomandojmë që, Komuna duhet të vendosë politika të përshtatshme dhe procedura që të sigurojë standart të lartë të qeverisjes, gjithashtu një Departament Auditit të Brendshëm dhe Komitet Auditit. Komiteti i auditit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime për sa i përket:

- Procesi i raportimit financiar dhe kontabilitetit të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga menaxhmenti;
- Proceset e auditit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Të sigurohet përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në të gjithë Komunën
- Përputhshmëria me kërkesatfinanciare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i Auditit të Brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të Auditit të Brendshëm.

VI. Konkluzioni i Përgjithshëm mbi Menaxhimin e Komunës Mamushe

Konkluzionet e përgjithshme

Siç u diskutua në këtë raport, përmirësime duhet të bëhen në fushat e të hyrave, trajtimit të të arkëtueshmeve, pagimi i detyrimeve brenda afatit të kërkuar, vlerësimi i pasurive kapitale dhe jo kapitale, auditimin e brendshëm dhe komiteti i auditimit.

Rekomandim i Përgjithshëm

- Pasqyrat financiare duhet të pregatiten në përputhshmëri me udhëzimet administrative aktuale dhe me SNKSP;
- Një sistem automatik i faturimit për të gjitha llojet e taksave duhet të formohet, duhet të kryhen barazimet në mes të zyrtarit të hyrave vetanake dhe departamenteve operacionale, si dhe duhet të ndërmerren masa që të rriten mbledhjet nga taksat e ndryshme; dhe
- Një Komitet Auditimi dhe Departament i Auditimit të Brendshëm duhet të ndërtohen në mënyrë që të kryejë detyrat dhe përgjegjësitë; dhe duhet të hartojë politika dhe procedura që të sigurojë standarte të larta në qeverisje.

Shtojca 1. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të aplikuar nga KPMG në Auditimin Vjetor 2012

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (Neni 14), apo është mohim i opinionit (Neni 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga Standartet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinioni i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinioni. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca 2: Rekomandimet e vitit te meparshem

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
Rezultatet financiare krahasuar me buxhetin e aprovuar	<p>Ne rekomandojmë Kryetarin të sigurojë që:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrolli i brendshëm lidhur me përdorimin e buxhetit në përputhshmëri me planifikimin të permisohet; dhe • Kontrollat për planifikim, menaxhim dhe monitorim të investimeve kapitalet ë përmirësohen në mënyrë që të arrijnë efektshmëri më të lartë të ekzekutimit të kontratës në kohë të caktuar. 			Rekomandimi nuk është adresuar
Pasqyrat financiare – Përputhshmëria me kornizën raportuese dhe cilesia e informacionit	<p>Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë që pregaditja e pasqyrave financiare të komunës duhet të përfshijë procedura dhe mjete të cilat janë të dizajnuara për të siguruar që informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare</p> <p>Komuna gjithashtu duhet të pregadisë pasqyrat financaire në gjuhën Serbe.</p>			Rekomandimi nuk është adresuar
Pasqyrat financiare – Përputhshmëria me kornizën raportuese dhe cilesia e informacionit	Përmirësime duhen bërë mbi cilësinë e informacionit te marrë dhe shpalosur në pasqyrat financiare			Rekomandimi nuk është adresuar
	Ne i rekomandojmë Kryetarit të sigurojë që Komuna do të ndërmerr hapat			Rekomandimi nuk

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
Menaxhimi financiar	<p>për të përmirësuar sistemin e faturimit dhe kontabël në mënyrë që të sigurojë kontrole të sigurta, efektive të faturimit dhe të të hyrave. Përmirësimi i procedurave të ndërlidhura me sisteme të tilla do të mundësonte për menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë risqe të rëndësishme, dhe të sigurojë që vendimet e ndërlidhura me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e të hyrave janë bartur në mënyrën e duhur.</p> <p>Ne rekomandojmë që Komuna të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Implementojë një sistem faturimi i cili përfshinë detaje të rifreskuara lidhur me paguesit, adresën e tyre aktuale, historinë dhe klasifikimin e mbledhjes. Informacioni i tillë duhet të jetë i lejuar vetëm për një numër të kufizuar të njerëzve dhe me autorizim nga menaxhmenti. • Të ekzistojë një lidhje automatike në mes të sistemit të faturimit dhe sistemit të kontabilitetit në mënyrë që informacioni të procesohet automatikisht në librin kryesor të kontabilitetit • Të ushtrrojë barazime të rregullta midis dysistemeve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Në rastet kur ka diferenca, atoduhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brendaafatit të caktuar. • Të lidhen automatikisht zyra e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes të tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyra operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksioneve. • Për të marrë informacione nga Qendra e Regjistrimit të Biznesit në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industrisë në lidhje me bizneset të cilat operojnë në Komunë dhe të ngarkojë ato për tatimet e përshkruara nga Ligjet dhe Rregulloret. 			është adresuar
Prokurimi	<p>Komuna duhet të themelojë procedura të kontrollit adekuate të mjaftueshme për monitorim efektiv mbi përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme.</p> <p>Ne e këshillojmë Kryetarin të sigurojë që Komuna të zbatojë në mënyrën e duhur kushtet e kontraktuara dhe të aplikojë gjëra kur kontraktuesi</p>		Rekomandimi është adresuar pjesërisht. Komuna ende ka nevojë për përmirësimin e kontrolleve mbi	

Komponenti i Auditimit	Rekomandimi i dhene	Rekomandimi i implementuar plotesisht	Pjeserisht i adresuar	I pa adresuar
	përfundon projektin në kohë. Kjo zbatohet veçanërisht kur kërkesa për të zgjatur afatin skadon siq është e përcaktuar në kontratë, nuk është dorëzuar.		prokurimet dhe të klasifikojnë të gjitha shpenzimet në kategorinë përkatëse.	
Subvencionet dhe transferet	Komuna duhet të themelojë procedura të kontroleve adekuate të mjaftueshme për monitorimin efektiv në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret aplikative.			Rekomandimi nuk është adresuar
Trajtimi i kapitalit dhe asetëve jo-kapitale	Ne i rekomandojmë kryetarit që të sigurojë se Komuna do të merr në konsiderim çështjet në vijim: <ul style="list-style-type: none"> • Të ndërmerren veprime konkrete, që do të mundësojnë regjistrim të menjëhershëm për të gjitha asetet në regjistra relevant në përputhshmëri me kërkesat e IA nr. 21/2009 dhe të cilat janë raportuar në mënyrë të saktë dhe të plotë. • Përfshijë burime shtesë në procesin e regjistrimit dhe vlerësimit të aktiveve të Komunës. • Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe të çertifikuar është e rekomanduar si praktika më e mirë për raste të tilla. • Kryerja e llogaritjeve të rregullta fizike për të siguruar ekzistencën e aktiveve dhe kushteve të tyre dhe të pajtohet me rezultatet e llogaritjeve me regjistrat kontabël dhe regjistrin. 		Rekomandimi është adresuar pjesërisht. Komuna ka kryer numërim fizik të aktiveve fikse, por vlerat nuk mund të gjurmohen në listën e asetëve fikse apo pasqyrave financiare informacion.	
Trajtimi i borxheve	Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të ndjek të gjitha provizionet e Udhëzuesit të Thesarit dhe rregullit financiar 02 – Shpenzimet e parasë publike e lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të zgjidh detyrimet përbrenda 30 ditëve.	Rekomandimi është adresuar		
